VENDIM
Nr. 172, datë 19.3.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 457, DATË 3.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PJESËMARRJE NË QENDRËN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËRKATËSE DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË LEKTORËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse dhe masën e shpërblimit të lektorëve", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9 shfuqizohet.

2. Shkronja "b", e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Trajnime *online*.".

3. Shkronja "a", e pikës 18/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/orë 60-minutëshe trajnimi, për kontratat me lektorët, të cilët do të përmbushin kriteret e mëposhtme:".

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama